

Raport Monitorimi

Bashkia Shkoder

Permbushja e Prioriteteve te Kontrates Sociale

Janar – Dhjetor 2024



Pergatitur nga:

Intelektualet e rinj, Shprese

Shkurt, 2025

Ky raport u pergatit me iniciativen e shoqates "Intelektualet e rinj, Shprese", për të nxitur angazhimin e pjesmarrjes qytetare në qeverisjen vendore si dhe për të promovuar transparencën dhe përgjegjshmërinë e të zgjedhurëve publikë, me mbështetjen financiare të Agjensisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Shqipëri përmes financimit të Qeverisë Shqiptare. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e autorit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikpamjet e Agjensisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe Qeverisë Shqiptare

FALENDERIME	4
HYRJE	5
PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
METODOLOGJIA	7
MONITORIMI I BASHKISË SHKODËR, PERIUDHA JANAR - DHJETOR 2024	8
PRIORITETI 1	8
PRIORITETI 2	10
PRIORITETI 3	15
PRIORITETI 4	17
PRIORITETI 5	18
PRIORITETI 6	20
TAKIME DHE AKTIVITETE ME QYTETARËT DHE GRUPET E INTERESIT	23
KONKLUZIONE	24
REKOMANDIME	26
REFERENCA	27

Falenderime

Për të hartuar këtë raport bashkëpunuam me shumë aktorë e institucione. Falenderojmë Bashkinë Shkodër dhe drejtoritë përkatëse për përgjigjet e shpejta brenda afatit kohor si dhe Këshillin Bashkiak Shkodër, për vënien në dispozicion të vendimeve të marra gjatë kësaj periudhe për të cilën është hartuar ky raport. Falenderojmë veçanërisht qytetarët që pranuan të përgjigjeshin pyetjeve tona.

Gjithashtu, dëshirojmë të falenderojmë *Agjensinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Shqipëri* për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohesh ky raport dhe të realizoheshin takimet me grupe të ndryshme qytetarësh dhe takime me të zgjedhurit vendorë.

HYRJE

Në vitin 2023 organizata "Intelektualet e rinj, Shpresë" organizoi disa takime me qytetarë dhe grupe të ndryshme interesi për të identifikuar problematikat kryesore për të cilat nevoiteshin zgjidhje dhe përfshirje në agjenden lokale vendimarrëse. Për të bërë të mundur që shqetësimet qytetare të degjoheshin u organizuan forume publike me kandidatët për kryetarë të Bashkisë Shkodër përpara zgjedhjeve lokale të 14 Majit 2023. Gjatë këtyre forumëve kandidatët për kryetarë Bashkie u ftuan që të nënshkruanin kontratat sociale të cilat përmbanin shqetësimet kryesore qytetare. Nënshkrimi i kontratave sociale bëri të mundur që të fiksohej si një premtim i shkruar i angazhimit të kryetarëve të zgjedhur për të përmbushur prioritetet e qytetareve brenda katër vjeçarit të mandatit të tyre.

Prioritetet e komunitetit bazohen në katër shtylla kryesore:

1.Shërbimet Publike

2.Demokracia Vendore dhe Mirëqeverisja

3.Zhvillimi Ekonomik Vendor

4.Dimensioni Social në Nivel Vendor

Kontrata Sociale për Bashkinë Shkodër e nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë z.Benet Beci dhe organizata "Intelektualet e rinj, Shpresë" përmban gjashtë prioritet kryesore të cilat janë:

1.Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integritetit evropian në nivel vendor

2.Drejtesia Sociale

3.Forcimi dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor

4.Transport publik i aksesueshëm dhe i sigurtë për të gjithë qytetarët e Shkodrës.

5.Shkollat, kopshtet dhe çerdhet

6.Infrastruktura rrugore

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024 "Intelektualet e rinj, Shpresë" ka vijuar me monitorimin e prioritetëve të qytetarëve të përfshira në Kontratën Sociale. Njëkohësisht është zhvilluar edhe monitorimi i procesit të konsultimeve publike në Bashkinë Shkodër për të cilin është publikuar edhe raporti përkatës¹. Gjatë periudhës së monitorimit janë dërguar gjithsej gjashtë kërkesa për informim si dhe janë monitoruar vendimet e Këshillit Bashkiak Shkodër, është organizuar një takim me administratën e Bashkisë Shkodër si dhe ka patur takime informale me grupe të ndryshme të interesit.

¹ Lexo raportin e plotë: http://irsh.al/wp-content/uploads/2024/09/Raporti-Studimor_IRSH_Shkoder.pdf

Përmbledhje Ekzekutive

- Ky raport monitorues synon të vlerësojë përmbushjen e angazhimeve të bashkisë Shkodër lidhur me prioritetet e Kontratës Sociale për periudhën Janar – Dhjetor 2024.
- Monitorimi është realizuar duke përdorur të dhëna nga dokumentet zyrtare të bashkisë nëpërmjet kërkesave për informim, monitorimit të kanaleve të informimit, takimet me qytetarët dhe inspektimet në terren.

Gjetjet kryesore tregojnë se:

- Bashkia Shkoder ka bërë progres të konsiderueshëm në përmirësimin e infrastrukturës dhe ofrimin e disa shërbimeve publike
- Bashkia Shkoder vazhdon të mos respektoj ligjin për barazinë gjinore në emërimin e administratorëve të njësive administrative.
- Transportik publik nuk rezultojn hapa konkretë për restaurimin e stacioneve të autobuzëve.
- Ngritja e terminalit të autobuzëve në Shkodër akoma nuk ka një vendim konkret për fillimin e realizimit të këtij projekti.

Bazuar në këto gjetje, rekomandojmë që:

- Bashkia Shkoder të marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e ligjit në emërimin e administratorëve të njësive administrative
- Bashkia Shkoder të përshpejtojë hapat për përmirësimin e transportit publik si një instrument i domosdoshëm për lëvizjen e qytetarëve dhe veçanërisht shtresave në nevojë grupeve vulnerabël dhe atyre me aftësi ndryshe.
- Për të konsoliduar arritjet në zbatimin e prioritetve të kontratës sociale nevojitet krijimi i aplikacioneve dixhitale që rrisin ndërveprimin qytetarë duke forcuar mekanizmat e konsultimit për të garantuar përfshirjen e tyre në procesin e vendimmarrjes.
- Gjetjet e këtij raporti, konkluzionet si dhe rekomandimet i shërbejnë rritjes së përgjegjshmërisë institucionale dhe zbatimin e detyrimeve të Kontratës Sociale nga Bashkia Shkodër për të ndërtuar besimin e nevojshëm dhe nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrjen lokale.

Metodologjia

Për të realizuar raportin, IRSH u bazua në hapat si më poshtë:

- Monitorimi i punës së Bashkisë Shkodër dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar – Dhjetor 2024;
- Shkëmbim informacioni nëpërmjet takimeve me përfaqësues të administratës së Bashkisë Shkodër, për tu informuar në lidhje me zbatimin e prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Shkëmbim informacioni nëpërmjet kërkesave për informim dërguar Bashkisë Shkodër
- Analizë dhe monitorim i vendimeve të Këshillit Bashkiak Shkodër që kanë lidhje me prioritetet e Kontratës Sociale;
- Takimi me qytetarët në lidhje me përmbushjen e prioriteteve të përcaktuara në Kontratën Sociale;
- Analizë dhe monitorim i mediave sociale të Bashkisë Shkodër dhe Këshillit Bashkiak;

Monitorimi i Bashkisë Shkodër, periudha Janar - Dhjetor 2024

Në lidhje me prioritetin e parë:

1. Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i axhendës së integrimit evropian në nivel vendor

1.1 Krijimi i një strategjie të re në shpërndarjen e informacionit, kryesisht për ato që lidhen ngushtësisht me interesat e qytetarëve dhe ndikimin e jetës së tyre si: programet e ndryshme të nxitjes së punësimit, biznesit, strehimit etj

1.2 Faqe interneti – vijimi i përditësimit, me informacion lehtësisht të aksesueshëm, e përditësuar me të gjitha informacionet e nevojshme që nuk kanë nevojë për kërkesë.

1.3 Fuqizimi i mekanizmave komunitar të përfaqësimit:

-Këshilli Vendor i Rinisë dhe ndikimi i tij në politikat vendore për të rinjtë. Fuqizimi i Këshillave vendorë lokalë si mekanizëm konsultues dhe monitorues i politikave rinore.

-Këshilli Vendor i Sigurisë Publike.

Rezulton se:

1. Këshilli Bashkiak ka miratuar me vendimin Nr.: 29 Dt.: 29.04.2024, "Për miratimin e Programit të Transparencës në Bashkinë Shkodër." Një detyrim ligjorë i cili është përmbushur nga Bashkia Shkodër e cila bën të mundur më tepër transparencë në vendimarrjen e Bashkisë Shkodër.

Rezulton se ky prioritet është duke u zbatuar nga Bashkia Shkodër!

2. Nga monitorimi i faqes zyrtare të Bashkisë në internet dhe rrjetet sociale informacionet përditësohen në mënyrë të rregullt në lidhje me të gjitha aktivitetet që zhvillon Bashkia Shkodër. Siç rezulton nga monitorimi i faqes së Këshillit Bashkiak Shkodër Këshilli Bashkiak Shkodër ka organizuar sesion informues me qytetarët me qëllim informimin e tyre mbi detyrat dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak dhe punën e bërë gjatë vitit të fundit². Po ashtu Bashkia Shkodër dhe Këshilli Bashkiak kanë përgatitur një video promocionale për promovimin e shërbimeve dhe nxitjen e qytetarëve në përfshirjen e tyre në vendimarrje dhe marrjen e shërbimeve³

Rezulton se Bashkia Shkodër dhe Këshilli Bashkiak janë të angazhuar seriozisht për të informuar qytetarët dhe përfshirjen e tyre në marrjen e shërbimeve dhe në vendimarrje!

² Per me teper vizito linkun: <https://www.facebook.com/share/p/1HJ3GydATk/>

³ Per me teper vizito linkun <https://fb.watch/xJJa9GOkIq/>

3. Nëpërmjet kërkesave për informim rezulton se Bashkia Shkodër për herë të parë ka ngritur **Këshillin Vendorë të Rinisë** (KVR) përbëhet nga 6 anëtarë si më poshtë:

1. **Z. Benet Beci** – Kryetar i Bashkisë Shkodër
2. **Z. Elsid Sekja** – Anëtar
3. **Z. Klajdi Kraja** – Anëtar
4. **Zj. Loreta Çermeli** – Anëtar
5. **Z. Kledis Dibra** – Anëtar
6. **Zj. Eleonora Lumçi** – Anëtar

Këshilli Vendor i Rinisë ka miratuar rregulloren e funksionimit dhe sipas kësaj ky këshill duhet të mbledhet jo më pak se 4 herë në vit. Në çdo mbledhje të Këshillit Vendor të Rinisë mbahet procesverbal i cili nënshkruhet nga sekretariati ose/dhe nga kryetari.

Nëpërmjet vendimit të Këshillit Bashkiak nr.29, datë 13.06.2022 është Miratuar rregullorja për **Krijimin Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Vendorë Për sigurinë Publike** (KVSP) në Bashkinë Shkodër. Sipas kësaj rregulloreje anëtarë të këtij Këshilli janë:

1. Kryetari i Bashkisë Shkodër
2. Shefi i Komisarariatit të Policisë Shkodër
3. Kryetar i Këshillit Bashkiak
4. Drejtues i Policisë Bashkiake
5. Përfaqësues nga Prefektura
6. Drejtues i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitarë
7. Drejtues i Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Publik
8. Drejtues i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetërorë
9. NJë përfaqësues i Komuniteteve Fetare
10. NJë përfaqësues nga Komuniteti I Biznesit
11. NJë përfaqësues nga Shoqëria Civile
12. Përfaqësues për Mbrojtjen dhe Emergjencën Civile në Bashki
13. Drejtuesi i Drejtorisë së Shërbimit Social dhe Strehimit në Bashki
14. Drejtues i Dejtorisë Ekonomike Arsimore në Bashki
15. Përfaqësues i Mediave Lokale

KVSP kryesohet nga Kryetari i Bashkisë i cili thërret mbledhjen dhe nënshkruan në emër të KVSP dokumentet zyrtare (rezolutat, ftesat, deklaratat për shtyp dhe media etj) dhe njëherë në gjashtë muaj është i detyruar të informoj Këshillin Bashkiak Shkodër për aktivitetin e zhvilluar.

<https://www.facebook.com/share/p/1BBLAvas5f/>

Rezulton se mekanizmat komunitarë të përfaqësimit janë ngritur dhe po funksionojn!
Pra përsa përshkruar mësipër rezulton se prioriteti i parë i Kontratës Sociale është duke u zbatuar me sukses!

Në lidhje me prioritetin e dytë:

2. Drejtësia Sociale

2.1 Promovimi i barazisë gjinore duke rritur përfaqësimin e grave në nivele drejtuese dhe duke zbatuar me korrektësi ligjin për barazinë gjinore në emërimin e nënkryetarëve dhe administratorëve.

2.2 Rritja e vlerës së bonusit të qerasë për nënat e divorcuara dhe me fëmijë; nënat vajza si edhe rritja e numrit të përfituesve.

2.3 Krijimi i aplikacioneve në celular që promovojnë shërbimet e qendrave sociale dhe mundësi të aksesit të programeve që zbatojnë për rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje

2.4 Krijimi i aksesit në infrastrukturë për personat me aftësi të kufizuara përmes ndërtimit të rampave në hapësira publike, shkolla dhe qendra shëndetësore.

2.5 Mirëfunksionimi i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në marrëdhëniet familjare dhe bashkërendimi i punës së autoriteteve përgjegjëse për menaxhimin e viktimave të dhunës në familje.

Rezulton se:

1. Sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore Nr. 139/2015, nenit 64, germa ë) përcaktohet se kryetari i Bashkisë *"emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, administratorët e njësive administrative/lagjeve dhe i shkarkon ata;"* sipas informacioneve të marra konstatohet se nuk është respektuar ligji për barazinë gjinore në emërimin e administratorëve të njësive administrative duke qene se që të gjithë janë meshkuj!
Ky prioritet i Kontratës Sociale i parashikuar në pikën 2,1 të saj rezulton i papërmbyshur!

2. Sipas komunikimeve zyrtare me Bashkinë Shkodër rezulton se në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar, VKM-së nr. 384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM -së nr. 453, datë 3.7.2019 "Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti", i ndryshuar, "VKM-së nr. 362, datë 20.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij" Bashkia Shkoder po zbaton disa nga programet sociale të strehimit, që kanë si qëllim krijimin e mundësi për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim.

Nga Monitorimi rezulton se Bashkia Shkodër është përzgjedhur si përfituese e një projekti që synon fuqizimin ekonomik të grave në zonat rurale në veri të Shqipërisë përmes krijimit

të mundësive të reja dhe përmirësimit të standardeve të jetesës. Ky Projekti do të zgjasë deri në vitin 2027 dhe përqendrohet në rritjen e punësimit, mbështetjen e vetëpunësimit dhe aftësimin profesional të grave në zonat rurale për vetëqëndrueshmëri ekonomike⁴.

Në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore, Bashkia Shkodër, në bashkëpunim me OSBE-në (OSCE Presence in Albania), ka organizuar një trajnim për punonjëset e saj, duke vënë theksin te rritja e ndërgjegjësimit për sigurinë e grave duke patur si qëllim forcimin e kapaciteteve të strukturave vendore për të adresuar dhunën me bazë gjinore dhe promovimin e mirëqenies, kujdesit për veten dhe sigurisë në vendin e punës⁵.

Gjatë kësaj periudhe është miratuar:

a) **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 7 Dt.: 31.01.2024**, "Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë e tregut të lirë për vitin 2024"

b) **Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr.: 21 Dt.: 29.04.2024**, "Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira në administrimin e Bashkisë Shkodër për vitin 2024."

c) **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 20 Dt.: 29.04.2024**, "Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e bashkisë Shkodër për projektin "Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen."

d) **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 35 Dt.: 31.05.2024**, "Për një ndryshim në VKB-në nr.7 datë:31.01.2024 "Për miratimin e listës së përfituesve për programin social të strehimit" "Banesa sociale me qira" për instrumentin financiar "Subvencionimi i qirasë në tregun..."

e) **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 47 Dt.: 31.07.2024**, "Për strehimin emergjent të zj. Xh. B dhe fëmijëve të mitur në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira pranë qendrës komunitare "Për familjen" nr. 6 (ish-konvikti i shkollës pyjore)".

Pra nga komunikimet zyrtare dhe Vendimet e miratuara nga Këshilli Bashkiak Shkodër rezultojn disa masa konkrete të ndërmarrë për të bërë të mundur subvencionimin e vlerës së bonusit të qirasë për shtresat sociale ku përfshihen nënat e divorcuara dhe me fëmijë dhe fuqizimin e shërbimeve për familjen!

3. Për gjithpërfshirjen e kategorive vulnerabël në aplikimin dhe përfitimin që i njih ligji, krijimin e lehtësirave të nevojshme për aplikuesit për këto programe dhe shpërndarjen sa më të saktë të informacionit, janë ndjekur këto hapa:
 - Publikimi i shpalljeve në faqen Web për aplikimet për të përfituar nga programet sociale të strehimit që zbaton Bashkia Shkodër;
 - Afishimi në ambientet e Z1N (Zyrës me një Ndalesë), Bashkia Shkodër;

⁴ Per me teper lexo lajmin: <https://www.facebook.com/watch/?v=1747759269398567&rdid=LkBWkMkV9yhJ5WYp>

⁵ Per me teper lexo lajmin: <https://www.facebook.com/share/p/1BYJdyqSDw/>

- Pritje, takime të specialistëve të Sektorit të Strehimit me qytetarët çdo të premte në ambientet e Bashkisë;
- Orari i takimeve nga specialistët e Drejtorisë së Shërbimit Social pranë Qendrave Komunitare dhe shpërndarja nga ana e tyre e informacionit në lidhje me programet e strehimit;
- Fletëpalosje (materiale promocionale).

Sipas informacionit menyrat e komunikimit që përdor Bashkia Shkodër janë:

- a) Faqet e internetit: www.bashkiashkoder.gov.al
- b) adresa email: sherbimetsociale@bashkiashkoder.gov.al
- c) Facebook: Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik Shkodër
- d) www.shkodrarinore.gov.al
- e) Facebook: Qendra Rinore Atelie
- f) Instagram; Qendra Rinore Atelia
- g) Instagram: Qendra Xixellonjat
- h) Polica Shtetit në numrin falas 112/129
- i) Linja Keshillimit për gra dhe vajza 116 117
- j) Linja kombëtare e keshillimit ALO 116 111
- k) Gruaja tek Gruaja 0693310172

Sipas informacionit të dhënë nga Bashkia Shkodër nuk rezulton se janë krijuar aplikacione mobile që promovojnë shërbimet e qendrave sociale dhe mundësi të aksesit të programeve që zbatojnë për rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje!

4. Sipas informacioneve të dhëna nga Bashkia Shkodër rikonstruksionet e Bashkisë Shkodër, Bibliotekës Marin Barleti janë krijuar përshtatshmëri për personat me aftësi ndryshe. Çdo ndërtim i ri dhe çdo rikonstruksion infrastrukturorë I realizuar nga Bashkia Shkodër ka përshtatshmërinë për PAK (rampa, ashensor, tualete etj) konkretisht, kanë tualete për PAK:
 - a) *Qendra Rinore Atelia*
 - b) *Qendra Komunitare Multifunksionale për Familjen*
 - c) *Qendra Komunitare Për Familjen Rrethina*
 - d) *Ambjentet e shoqatës së Para&Tetraplegjikëve*

Po ashtu në infrastrukturën rrugore të Bashkisë Shkodër me qëllim përmirësimin e aksesueshmërisë për PAK janë ndërtuar një sërë rampash të reja. Në bashkpunim me shoqatën e Para Tetraplegjikëve dhe me mbështetjen e UNDP Albania janë përmirësuar parkingjet e rezervuara për PAK duke i paisur me badge të dedikuara si dhe marrjen e masave shtrënguese për ata që bëjnë shkelje duke i përdorë me pa të drejtë.

Të gjitha institucionet arsimore të rikonstruktura kanë përshtatjen e duhur për të siguruar aksesueshmërinë dhe po punohet për përshtatshmërinë në çdo shkollë të qytetit dhe njësive administrative. Për herë të parë janë ndërtuar parqe publik lojrash për fëmijët e Bashkisë Shkodër duke përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

Në shkollën speciale **“3 Dhjetori”**, një shkollë e dedikuar për fëmijët me aftësi të kufizuara, përveç procesit mësimorë dhe edukativ ofrohet shërbimi i transportit dhe shërbimi i trajtimit ushqimor për nxënësit që frekuentojnë këtë shkollë. Automjetet që përdoren për transportin e fëmijëve tek shkolla speciale **“3 Dhjetori”** kanë përshtatshmërinë e duhur për personat me aftësi të kufizuara.

Në shkollën **“Skanderbeg”** të qytetit të Shkodrës në bashkpunim me World Vision është ndërtuar dhe funksionon **“Hapsira Zhvillimore”** si një model inovativ i shërbimeve të integruara i cili bazohet në nevojat e ndryshme në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve e që nxit partneritetin mes shkollës dhe profesionistëve/specialistëve për të ofruar shërbime të integruara psiko-sociale, zhvillimore, terapeutike brenda hapsirave shkollore me qëllim zhvillimin e fëmijëve dhe me fokus të veçantë të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Po ashtu është vënë në funksion **Qendra Harmonia** e cila ofron shërbime të specializuara për fëmijët me spektrin autik.

Në kuadër të 3 Dhjetorit, Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, Bashkia Shkodër ka organizuar një aktivitet ndërgjegjësues pranë ambjenteve të Shoqatës së Invalidëve **“Para & Tetra Plegjikëve”** dhe shkollës **“Ali Laçej”**⁶. Po ashtu në Ditën Botërore të Personave me Aftësi të Kufizuar, u zhvillua një garë simbolike vrapimi, për të theksuar respektimin e të drejtave dhe dinjitetit të tyre⁷.

Sipas informacionit të dhënë dhe verifikimeve në terren rezulton se janë krijuar akseset në infrastrukturë për personat me aftësi të kufizuara përmes ndërtimit të rampave në hapësira publike, shkolla dhe qendra shëndetësore!

5. Sipas informacionit të dhënë nga Bashkia Shkodër, në zbatim të VKM, nr.334, datë 17.02.2011 **“Për mekanzimin e bashkrendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”** ndryshuar me VKM Nr.327, datë 02.06.2021, në Bashkinë e Shkodrës janë të ngritur dhe funksional:
 - a) **Komiteti drejtues** i drejtuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe i përbërë nga drejtuesit e insitucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në nivel vendor
 - b) **Ekipi teknik ndërdisiplinor** i përbërë nga përfaqësues teknik të institucioneve pjesë të komitetit drejtues
 - c) **Kordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës** në marrëdhëniet familjare i cili është përfaqësues i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

⁶ Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/share/p/15rTNMKQTZ/>

⁷ Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/watch/?v=1275811100114680&rdid=2va1FRZfTTuYRh9x>

Ekipi Teknik Ndërdisciplinorë mblidhet ad-hoc në varësi të rasteve të dhunës në familje dhe problematikave që paraqet çdo rast konkret ose brenda 24-48 orëve, javës kur është identifikuar rasti. Ky ekip mblidhet me kërkesën e institucionit, pjesë e mekanizmit, i cili ka identifikuar rastin (psh: policia, organizata, Bashkia, qendra komunitare). Për të gjitha rastet janë hartuar dhe dërguar raportet përkatëse të monitorimit çdo 60 ditë në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër.

Për çdo rast të personave të dhunuar ofrohen shërbime parashoqërore (informimi, orientimi, këshillimi, shërbime në familje, mbështetje psiko-sociale dhe ndërhyrje të hershme) shërbime komunitare (mbrojtja e femijeve, shërbime për fëmijën dhe familjen

Rezulton se Mekanizmi i Koordinuar i Referimit kundër dhunës në marrëdhëniet familjare dhe bashkërendimi i punës së autoriteteve përgjegjëse për menaxhimin e viktimave të dhunës në familje mirëfunksionon në mënyrë të kënaqshme!

Në lidhje me prioritetin e tretë:

3. Forcimi dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor

3.1 Promovimi i burimeve natyrore nëpërmjet nxitjes së biznesit dhe punësimit të të rinjve në zonat bregdetare dhe malore përmes krijimit të portaleve me profil ekonomik për shkëmbim informacioni dhe zhvillimin e programeve të përshtatura për këtë kategori.

3.2 Nxitja e sipërmarrjes rinore nëpërmjet programeve që ofrojnë grante dhe stimuj fiskalë për sipërmarrësit e rinj në ngritjen e bizneseve të reja, me qëllim nxitjen e sipërmarrjes së të rinjve dhe mbështetjen e tyre.

Rezulton se:

1. Këshilli Bashkiak Shkodër ka miratuar:

a) **Vendimin Nr.: 3 Dt.: 31.01.2024**, "Për Miratimin e Hartës së Përgjithshme të Plazheve të Lejuara në Territorin e Liqenit të Shkodrës, Bashkia Shkodër"

b) **Vendimin Nr.: 2 Dt.: 31.01.2024**, "Për Miratimin e Hartës së Përgjithshme të Plazheve të Lejuara në Territorin Bregdetar të Njësisë Administrative Velipojë, Bashkia Shkodër"

Vendimet e mësipërme synojnë disiplinimin e Plazheve në territorin liqenor dhe bregdetarë të cilat krijojnë njëkohësisht edhe mundësi punësimi për të rinjtë.

2. Në datat 24-26 Tetor 2024, Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Lëvizjen rinore "Të Rinj me Themel", Qendra Rinore Atelie dhe YEA - Young Entrepreneurs Albania, ka organizuar në Shkodër një workshop mbi biznesin me lektorë dhe biznesmenë nga Zvicra, duke patur si qëllim nxitjen e bizneseve të reja dhe forcimin e bizneseve që janë në hapat e parë⁸.

Në datën 8 Nëntor 2024, Bashkia Shkodër, në bashkëpunim me GIZ Albania, ka lançuar nisjen e një program të ri inovativ – TIP – Tourism Innovation Platform. Ky program synon të mbështesë zhvillimin e produkteve të reja turistike që lidhin natyrën, trashëgiminë kulturore, kulinarinë dhe aventurën në zonat me potencial për zhvillim. Nëpërmjet TIP, bizneset që dëshirojnë të krijojnë oferta të reja turistike në territorin tonë do të përfitojnë mbështetje për mentorim dhe financim, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në Shkodër⁹.

Me datën 6 Dhjetor 2024, Bashkia Shkodër në kuadër të projektit "Skemë granti për të rinjtë", në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale, duke ruajtur një qasje miqësore ndaj mjedisit, ka shpallur konkursin e hapur për dorëzimin e aplikimeve për grante, si një mundësi e re ekonomike për sipërmarrësit aspirantë dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-ve) të aftë për të qenë të qëndrueshëm në një treg konkurrues. Qëllimi i kësaj thirrje ishte të mbështesë plane të qëndrueshme biznesi të krijuara nga të rinjtë e qytetit të Shkodrës, të cilët shfaqin aftësi të mbijetojnë në një treg konkurrues. Procesi i përzgjedhjes së aplikantëve kishte si qëllim të ofrojë

⁸ Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/share/p/161kt3Cv7U/>

⁹ Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/share/p/1Fc7FQWYyv/>

transparencë dhe konkurrencë të barabartë si dhe të mbështesë idetë dhe planet e biznesit më të mira, inovative, fitimprurëse dhe që garantojnë rezultate të qëndrueshme. Skema është planifikuar të zbatohet në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër e fokusuar ne Turizëm/ Agroturizëm, Mjedis, Energji e rinovueshme, Shërbime, Artizanat, Teknologjia e informacionit dhe zhvillimit.

Me datën 20 Dhjetor 2024, Bashkia Shkodër ka organizuar në Stadiumin Loro Boriçi, CCL Shkodra Demo Day ku u paraqitën 9 startup-e dhe zgjidhjet e tyre novatore për një të ardhme qarkulluese dhe të jetueshme. Një shpalosje e inovacionit lokal, ku 5 të rinj u shpallën fitues me idetë më të mira, të cilët do të financohen nga donatorët (ose partnerët) gjermanë me 200,000 euro¹⁰.

Përsa mësipër rezulton se ka një angazhim konkret të Bashkisë Shkodër në përmbushjen e prioritetit të tretë ku siç është përshkruar mësipër janë zhvilluar një sërë iniciativash!

¹⁰ Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/share/p/17LQ49r5ec/>

Në lidhje me prioritetin e katërt:

4.Transport publik i aksesueshëm dhe i sigurtë për të gjithë qytetarët e Shkodrës.

- 4.1 Përfundimi dhe vënia në funksion e terminalit të autobusëve në Bashkinë Shkodër.
- 4.2 Restaurimi i stacioneve të autobusit ku të publikohet dhe respektohet orari.
- 4.3 Rritja e frekuencës së lëvizjes së autobusëve si dhe shtimi i linjave që lidhin fshatrat me qytetin Shkodër.

Rezulton se:

1. Sipas informacionit të dhënë nga Bashkia Shkodër, terminali i autobusëve në Bashkinë Shkodër është një investim që lidhet në aspektin e financimit me "Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugorë" dhe bashkia Shkodër është në komunikime të vazhdueshme për zhvillimin e këtij projekti.
2. Sipas informacionit të Bashkisë Shkodër, restaurimi i stacioneve të autobuzëve Bashkia Shkodër ka arritur një marrëveshje me operatorin "ERGYS 2010MS shpk" i cili ushtron aktivitetin në shërbimin e transportit qytetës dhe është në vijim të procedurave përkatëse për zhvillimin e këtij projekti.
3. Gjatë kësaj periudhe është miratuar vendimi nr.68 datë 06.11.2024 *"Për një ndryshim dhe shtesë në VKB Nr.5 dt:05.01.2022 "Për miratimin e rrjetit të linjave dhe tarifës së biletave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve për periudhën afatmesme 2022-2024 në Bashkinë Shkodër"* i cili konsiston kryesisht në *"Miratimin e linjës së rregullt ndërqytetase të transportit të udhëtarëve Shkodër-Shosh-Shkodër, me dy drejtime lëvizje, sipas tabelës Nr.1 bashkëlidhur vendimit*

Përsa mësipër rezulton se Prioriteti katërt nuk ka zhvillime konkrete në zbatimin e tij!

Në lidhje me prioritetin e pestë:

5.Shkollat, kopshtet dhe çerdhet

5.1 Funksionimi i sistemeve të ngrohjes në infrastrukturat shkollore duke garantuar lëndën e parë për vendosjen në punë të kalidajave pa kufizim.

5.2 Rregullimi i infrastrukturës arsimore në Njësitë Administrative.

5.3 Krijimi i terreneve të reja sportive dhe restaurimi i këndeve sportive dhe palestrave të shkollave të qytetit për promovimin e sportit si stil i shëndetshëm jetese për të rinjtë dhe qytetarët.

Rezulton se:

1.Gjatë kësaj periudhe është miratuar:

a) **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 48 Dt.: 31.07.2024** "Dhënie pëlqimi për pranimin e sponsorizimit nga subjekti 'Raiffeisen Invest', Sh.a në cilësinë e sponsorizuesit për investim dhe zbatim në kuadër të "Rikualifikimit të hyrjeve së disa shkollave të qytetit, Shkodër".

b) **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 42 Dt.: 28.06.2024**, "Për miratimin në parim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe Bashkisë Shkodër për zbatimin e projektit "Sunny Schools", i cili ka për qëllim instalimin e impianteve Fotovoltaike (prodhim energjie elektrike përmes energjisë diellore) në shkollat e mesme " Jordan Misja", " Oso Kuka", " Nikolle Zagorjani" dhe shkollat 9 Vjeçare " Dëshmorët e Prishtinës", "Edith Durham" , " Tringë Smajli" Grudë, " Dëshmorët Rrencit" ..."

c) **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 45 Dt.: 31.07.2024**, "Për dhënie pëlqimi për pranimin e donacionit nga World Vision Albania, në cilësinë e donatorit për investimin dhe zbatimin e projektit "Kënd lojrash".

Vendimet e mësipërme të Këshillit Bashkiak janë në funksion të rregullimit të infrastrukturës së disa shkollave të qytetit të Shkodrës si dhe një këndi lojrash. Po ashtu ndërhyrje do të ketë në instalimin e impianteve fotovoltaike për prodhim energjie përmes energjisë diellore në shkollat e mesme " Jordan Misja", " Oso Kuka", " Nikolle Zagorjani" dhe shkollat 9 Vjeçare " Dëshmorët e Prishtinës", "Edith Durham" , " Tringë Smajli" Grudë, " Dëshmorët Rrencit" ..."

Me datë 22 Tetor 2024, sipas monitorimit të faqes sociale të Bashkisë rezulton se në Shkollën "3 Dhjetori" janë realizuar riparime hidraulike që do të përmirësojnë kushtet e mësimi. Po ashtu, në Kopshtin dhe Shkollën në Kuç janë kryer punime për lyerjen dhe riparimin e dyerve dhe dritareve duke ofruar një ambient më të mirë për nxënësit ¹¹.

¹¹ Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/share/p/19iZMNpfEr/>

Me datë 07 Nëntor 2024 Në shkollën e mesme “Kolë Idromeno” ka nisur rikonstruksioni i plotë i saj. Një investim që do t'i transformojë ambientet e kësaj shkolle duke krijuar kushte cilësore për nxënësit¹².

Me datë 07 Nëntor 2024, në shkollën “Martin Camaj” ka nisur rikonstruksioni i plotë i tarracës nga Ndërmarrja e Menaxhimit të Objekteve Publike të Bashkisë Shkodër¹³.

Me datë 13 Nëntor 2024, në shkollën 9-vjeçare “Agim Tafili” në Bërdicë është realizuar ndërhyrja nga Drejtorisë së Menaxhimit të Objekteve Publike prane Bashkisë Shkodër

Pra përsa përshkruar mësipër rezulton se prioriteti i pestë i Kontratës Sociale është duke u zbatuar në përgjithësi, më tepër vëmendje duhet kushtuar në krijimin e terreneve të reja sportive dhe restaurimin e këndeve sportive dhe palestrave të shkollave të qytetit për promovimin e sportit si stil i shëndetshëm jetese për të rinjtë dhe qytetarët!

¹² Per me teper lexo <https://www.facebook.com/share/p/1BQr7y2Fjs/>

¹³ Per me teper lexo <https://www.facebook.com/share/p/1BKuzqpJ7q/>

Në lidhje me prioritetin e gjashtë:

6. Infrastruktura rrugore

6.1 Mirëmbajtje e segmenteve rrugore të qytetit

6.2 Përmirësim i ndriçimit dhe elementëve të sigurisë rrugore.

6.3 Ndërtimi i rrugës së Dukagjinit sipas segmentit Prekal-Kir-Pult-Shalë

Rezultoni se:

1. Sipas informacionit të dhënë nga Bashkia Shkodër nëpërmjet shkresës nr.2147.prot, datë 3 Shkurt 2025, ndërmarrja e shërbimeve dhe punëve publike pranë Bashkisë Shkodër ka në fokusin e saj Mirëmbajtjen e Infrastrukturës rrugore të qytetit.

2. Në lidhje me ndriçimin rrugor Bashkia Shkodër njofton se përgjatë vitit 2024, janë realizuar keto investime:

a) Përfundimi i projektit SEMP "Investime në kuadër të projektit "Bashki në shfrytëzim inteligjent energjie" (Bashki të zgjuara energjie), ku u investu në rehabilitimin dhe përmirësimin e ndriçimit rrugor në 11 rrugë të qytetit Shkodër.

b) Fillimi dhe implementimi (vazhdim dhe përgjatë 2025) i projektit "Ndriçim i rrugëve plazh Velipojë", ku përgjatë vitit 2024 u vendosën 209 ndriçues të teknologjisë së fundit LED të shpërndara në 8 rrugë në Velipojë.

c) Investim me fonde të veta dhe punëtori të Ndërmarrjes së Shërbimeve dhe Punëve Publike për instalimin e 150 ndriçuesve të rinj të shpërndara në të gjitha njësitë administrative. Ketu mund të përmendim rrugë të reja të ndriçuara si Shtoj i Vjetër, Bërdicë e Madhe, Bërdicë e Mesme, Fshati i Paqes Shirokë, Dragoc, Fshat i ri, Boks, Drisht, Sheldi, Rrenc, Vukatanë, Juban, Gur i Zi, Vejukej dhe Gorice

Sipas monitorimit të Bashkisë Shkodër:

Me datën 24 Tetor 2024, ka përfunduar sistemimi dhe asfaltimi i rrugës në lagjen Tepe nga Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike në Bashkinë Shkodër¹⁴.

Me datën 25 Tetor 2024 në Bulevardin "Bujar Bishanaku" janë kryer ndërhyrje për përmirësimin e sinjalistikës rrugore për një qarkullim më të sigurt në qytet.¹⁵

¹⁴ Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/share/p/165xM2CMpt/>

¹⁵ Per me teper lexo <https://www.facebook.com/share/p/17YJpD17i1/>

Me datën 29 Tetor 2025, ndërhyrje në bllokun e pallateve "Isuf Sokoli"¹⁶

Me datën 4 Nëntor 2024, në vazhden e perpjekjeve për përmirësimin e infrastrukturës urbane në qytet është realizuar vijëzimi i rrethrotullimit në sheshin Rus, duke kontribuar për një qytet më të sigurt dhe të organizuar¹⁷.

Me datën 12 Nëntor 2024, është kryer ndërhyrje me asfaltimin e rrugës "Besnik Ceka" në qytet, duke sjellë përmirësime të rëndësishme për qarkullimin në këtë zonë¹⁸.

Me datën 15 Nëntor 2024, në Gjuhadol bashkë me DRTK-në ka nisur ndërhyrja për riparimin e disa fasadave të amortizuara që krijojnë rrezik për banorët në këtë zonë.

Me datën 20 Nëntor 2024 është riparuar segmenti përgjatë rrugës "Ludovik Saraçi" dhe "Marin Biçikemi"¹⁹.

Me datën 21 Nëntor 2024, në Rrugën Pogej kanë vazhduar punimet për riparimin e trotuarit, duke përmirësuar infrastrukturën dhe sigurinë për qytetarët²⁰.

Me datën 25 Nëntor 2024, ka përfunduar procesi i zëvendësimit të ndriçuesve me teknologji LED në Bulevardin "Skënderbeu", duke garantuar një ndriçim më efikas, cilësi më të lartë, dhe ulje të ndjeshme të konsumit të energjisë elektrike²¹.

Me datë 1 Dhjetor 2024, rezulton se në zonën e Fermentimit ka nisur prej ditësh puna për rikonstruksionin e plotë të rrugëve dhe rrugicave. Mbi 200 shtëpi janë përfituese të këtij investimi të Bashkisë Shkodër dhe Ministrisë së Ekonomisë. Projekti parashikon rikonstruksionin e rrugës, rrjetin e kanalizimeve dhe ndriçimin²².

Me datën 3 Dhjetor 2024, kanë vijuar punimet për riparimin e trotuarit në Rrugën "Hafiz Sabri Bushati", për ta bërë më të sigurt dhe të aksesueshëm për këmbësorët²³.

Me datën 13 Dhjetor 2024, ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike ka ndërhyrë në rrugët "Hafiz Sabri Bushati", "Marin Biçikemi", "3 Heronjtë", "Tano Banushi", "Pashko Gjeçi", "Zef Juban Ilia", "Danja" dhe "Sarda", për përmirësimin e infrastrukturës rrugore në këto zona. Punë të përditshme në shërbim të banorëve të Shkodrës²⁴.

¹⁶ Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/share/p/19y9qrtT21/>

¹⁷ Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/share/p/19vtdmEPYc/>

¹⁸ Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/share/p/14bYpJYwCy/>

¹⁹ Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/share/p/14zbU5sJ73/>

²⁰ Per me tepr lexo: <https://www.facebook.com/share/p/19cZwM5U3z/>

²¹ Per me teper lexo <https://www.facebook.com/share/p/18zYvKc7PV/>

²² Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/share/p/1A6bvoCykM/>

²³ Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/share/p/16C8AFTadW/>

²⁴ Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/share/p/1BCTtNGsTH/>

Me datën 16 Dhjetor 2024, Në Njësinë Administrative Rrethina, Shtoj i Ri, kane vijuar punimet për vendosjen e ndriçimit rrugor. Ky projekt përmirëson urbanistikën, sigurinë dhe cilësinë e jetës për banorët e zonës²⁵.

Me datë 24 Dhjetor 2024 Po realizohet riparimi i rrugës në Golem, Njësia Administrative Rrethina, për lehtësimin e qarkullimit në këto zona²⁶.

4. Sipas monitorimit të bërë nga faqja e Bashkisë rezulton se rreth 90% e punimeve në lotin e parë të rrugës, i cilësuar si më i vështiri janë kryer. Projekti konsiston në sistemimin, profilizimin e rrugës si dhe vendosjen e tombinove dhe mureve mbajtës nga fshati Prekal, deri në hyrje të fshatit Lotaj, si dhe në restaurimin e veprave ekzistuese të artit dhe shtimin e tyre aty ku janë të domosdoshme. Rruga do të ketë një gjerësi të përgjithshme prej 5 metrash, duke ruajtur aksin e rrugës ekzistuese.²⁷

Pra përsa përshkruar mësipër rezulton prioriteti i gjashtë i Kontratës Sociale është duke u zbatuar me sukses ku në të gjitha komponentat e tija ka zhvillime të aktiviteteve

²⁵ Per me teper lexo <https://www.facebook.com/share/p/15o8Fqs9yk/>

²⁶ Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/share/p/1A1uPnYebD/>

²⁷ Per me teper shiko: <https://www.youtube.com/watch?v=rhgo5i45Lvk>

Takime dhe aktivitete me Qytetarët dhe grupet e interesit

Në kuadër të këtij projekti kemi realizuar takime me qytetarë dhe grupe interesi:

1. Me datën 3 Qershor 2024 kemi lançuar një survey online për tu plotësuar nga grupe të ndryshme interesi në lidhje me procesin e konsultimeve publike në funksion të përgatitjes së Raportit Studimore për proceset konsultuese në Bashkinë Shkodër²⁸

2. Me datën 09 Gusht 2024 shoqata "Intelektualet e rinj, Shpresë" ka publikuar raportin Studimor "Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor – Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik në bashkinë Shkodër" Bashkia Shkodër²⁹

3. Me datën 15 Nëntor 2024, në një takim të organizuar në Bashkinë Shkodër janë prezantuar gjetjet e raportit studimor "Transparenca dhe përgjegjësia në nivel vendor - Vlerësimi i proceseve të konsultimit publik në Bashkinë Shkodër". Përfaqësues nga Bashkia, Këshilli Bashkiak dhe organizatat lokale morën pjesë në takim, duke diskutuar gjetjet, metodologjinë dhe rekomandimet e raportit. Procedura të unifikuara të pjesëmarrjes qytetare si një proces transparent dhe i drejtpërdrejtë mes administراتës së bashkisë, anëtarëve të KB dhe qytetarëve për këshillimin, shkëmbimin e opinioneve për politikën, legjislacionin dhe normat që rregullojnë vetëqeverisjen vendore ishin pikat kryesore të diskutimit në këtë takim³⁰.

4. Me datën 19 Nëntor 2024 është organizuar Konferenca Kombëtare "Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik". Në këtë konferencë janë diskutuar gjetjet e raporteve studimore sipas Bashkive respektive³¹

5. Me datën 21 Nëntor 2024 përfaqësues të organizatës kanë marrë pjesë në diskutimet e organizuara në sallën e Këshillit Bashkiak Shkodër në lidhje me draftin e Planit të ri Social të Bashkisë Shkodër³²

6. Me datën 13-14 Dhjetor 2024 është organizuar Workshopit me anëtarët e Rrjetit POP për Monitorimin dhe Vlerësimin e Demokracisë dhe Drejtësisë Lokale duke ballafaquar gjetjet e punës monitoruese dhe përcaktuar indikatorët e referencës për finalizimin e raporteve monitoruese³³

²⁸ Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/share/p/15zkC5Sb5N/>

²⁹ Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/share/p/1BQbGAmEv5/>

³⁰ Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/share/p/1BGxyNRf3o/>

³¹ Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/share/p/19qASWmNcE/>

³² Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/share/p/1Gg27QgXmY/>

³³ Per me teper lexo: <https://www.facebook.com/share/p/12CdUf4r8YU/>

Konkluzione:

Përsa analizuam mësipër nëpërmjet gjetjeve të identifikuar nga informacionet zyrtare të grumbulluara nëpërmjet kërkesave për informacion, faqes zyrtare dhe rrjeteve sociale të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak, rezulton se përsa i takon:

1. Prioritetit të parë të Kontratës Sociale:

1.1 Bashkia ka rishikuar dhe miratuar një program transparence sipas detyrimeve dhe dispozitave ligjore.

1.2 Bashkia Shkodër dhe Këshilli Bashkiak janë të angazhuar seriozisht për të informuar qytetarët dhe përfshirjen e tyre në marrjen e shërbimeve dhe në vendimarrje nëpërmjet fushatave të ndryshme ndërgjegjëse!

1.3 Mekanizmat komunitar të përfaqësimit siç janë Këshilli Vendorë i Rinisë dhe Këshilli Vendorë Për sigurinë Publike janë ngritur dhe funksionojnë

2. Prioritetit të dytë të Kontratës sociale:

2.1 Bashkia Shkodër ka respektuar ligjin për barazinë gjinore për emërimin e nënkryetarëve por vazhdon të veprojë në kundërshtim me zbatimin e ligjit për barazinë gjinore në emërimin e administratorëve.

2.2 Bashkia Shkodër ka ndërmarrë hapa konkretë dhe Këshilli Bashkiak Shkodër ka miratuar disa vendime të cilat synojnë subvencionimin e vlerës së bonusit të qirasë për shtresat sociale ku përfshihen nënat e divorcuara dhe me fëmijë dhe fuqizimin e shërbimeve për familjen!

2.3 Bashkia Shkodër nuk ka krijuar akoma aplikacione mobile që promovojnë shërbimet e qendrave sociale dhe mundësive të aksesit të programeve që zbatojnë për rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje!

2.4 Bashkia Shkodër ka krijuar akseset në infrastrukturë për personat me aftësi të kufizuara përmes ndërtimit të rampave në hapësira publike, shkolla dhe qendra shëndetësore!

2.5 Mekanizmi i Koordinuar i Referimit kundër dhunës në marrëdhëniet familjare dhe bashkërendimi i punës së autoriteteve përgjegjëse për menaxhimin e viktimave të dhunës në familje mirëfunksionimi në mënyrë të kënaqshme!

3. Prioritetit të tretë të Kontratës sociale:

3.1 Janë kryer një sërë iniciativash të përshkruara në raport të cilat promovojnë dhe nxisin biznesin dhe punësimin e të rinjve.

3.2 Nëpërmjet programeve që ofrojnë grante dhe stimuj fiskalë për sipërmarrësit e rinj është bërë e mundur nxitja e sipërmarrjes së të rinjve dhe mbështetja e tyre.

4 Prioritetit të katërt të Kontratës sociale:

4.1 Projekti i terminalit të autobusëve në Bashkinë Shkodër akoma nuk është perfundur ndërkohë që vazhdojnë komunikimet ndërmjet "Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugorë" dhe Bashkisë Shkodër.

4.2 Restaurimi i stacioneve të autobuzëve akoma nuk është kryer ndërkohë që Bashkia Shkodër ka arritur një marrëveshje me operatorin "ERGYS 2010MS shpk" i cili ushtron aktivitetin në shërbimin e transportit qytetës dhe është në vijim të procedurave përkatëse për zhvillimin e këtij projekti.

4.3 Ndërkohë, Këshilli Bashkiak Shkodër me vendimin nr.68 datë 06.11.2024 ka miratuar shtimin e një linje të rregullt ndërqytetase të transportit të udhëtarëve Shkodër-Shosh-Shkodër, me dy drejtime lëvizje,

5. Prioritetit të pestë të Kontratës sociale:

5.1 Në disa shkolla ka patur ndërhyrje për të bërë të mundur funksionimin e sistemeve të ngrohjes si dhe në rregullimin e infrastrukturës shkollore.

5.2 Janë identifikuar disa projekte të cilat kanë bërë ndërhyrje dhe përmirësime në infrastrukturën arsimore në shkollat e Bashkisë Shkodër.

5.3 Ndërkohë nuk ka patur ndërhyrje të dukshme në krijimin e infrastrukturës sportive në shkolla siç janë kënde sportive dhe palestra.

6 Prioritetit të gjashtë të Kontratës sociale:

6.1 Ka patur në shumë rrugë të qytetit ndërhyrje për mirëmbajtjen e segmenteve rrugore të qytetit duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën dhe sigurinë rrugore

6.2 Në shumë rrugë dhe lagje të qytetit është përmirësuar ndriçimi duke u bërë edhe ndërrimi i tyre me ndriçim led

6.3 Ka përfunduar loti i parë i ndërtimit të rrugës së Dukagjinit sipas segmentit Prekal-Kir-Pult-Shalë

Rekomandime

Duke vlerësuar progresin në zbatimin e kontratës sociale është e nevojshme që ato hapa pozitive të konstatuar të konsolidohen dhe rezultatet të mbeten të qëndrueshme gjatë periudhës në vazhdim përsa mësipër rekomandohet **si prioritare**:

1. Bashkia Shkodër të marrë masa të menjëhershme për të respektuar ligjin për barazinë gjinore në emërimin e administratorëve
2. Përsheptimin e hapave për ndërhyrje emergjente në rregullimin e transportit publikë duke filluar menjëher me restarumin e stacioneve të autobuzëve si dhe me finalizimin e projektit dhe fillimin e zbatimit të tij për ndërtimin e terminalit të autobusëve në Bashkinë Shkodër
- 3 Të ketë një vëmendje të shtuar në lidhje me krijimin e infrastrukturës sportive në shkolla siç janë kënde sportive dhe palestrat

Në mënyrë që Bashkia Shkodër të krijoj qëndrueshmëri në rezultatet e arritura këshillohet:

- a) Të krijoj programe dhe aplikacione mobile të cilat ofrojnë informacion mbi shërbimet që ofron bashkia Shkodër si dhe mundësisht të gjindet mundësia e ndërveprimit dhe shkëmbimit informacionit online me qytetarët.
- b) Në lidhje me Mekanizmat komunitar të përfaqësimit të cilat janë ngritur tashmë të krijojnë një ndërlidhje me qytetarët dhe grupet e interesit duke rritur ndërveprimin për të influencuar vendimarrjen në varësi të nevojave
- c) Grupet qytetare, grupet e interesit, organizatat e shoqërisë civile si dhe rinia studentore duhet që të afrohen jo thjesht nëpërmjet dhënies së ideve por edhe prezantimit të projekteve, strategjive apo ndërhyrjeve afatshkurtra apo afatmesme për zgjidhjen e çështjeve të caktuara në komunitet.
- d) Bashkia duhet që të shohë mundësi me mbështetje nga buxheti i saj për nxitjen e iniciativave që forcojnë rolin e komunitetit në vendimarrje duke ndikuar drejtpërsëdrejti në një qeverisje të mirë.
- e) Organizatat e shoqërisë civile dhe komuniteti duhet të përfshihen në proceset vendimmarrëse jo vetëm si dëgjues por edhe si pjesë të grupeve të punës në funksionin monitorues dhe këshillues.

Referenca

- Faqja web Bashkia Shkodër <https://www.bashkiashkoder.gov.al/>
- Rrjeti Social Facebook Këshilli Bashkiak Shkodër <https://bit.ly/3luiMdg>
- Rrjeti social Facebook Bashkia Shkodër <https://www.facebook.com/bashkiashkodres>
- Faqja zyrtare e Kryetarit të Bashkisë Shkodër <https://www.facebook.com/beci.benet>
- VENDIMET E KESHILLIT BASHKIAK Shtator 2023 – Dhjetor 2024
- Njoftim per mbledhjen: <https://www.facebook.com/share/p/1Bnv986DsL/>
- Transmetim Live: <https://fb.watch/xP4-yXgZrF/>
- Facebook link <https://www.facebook.com/share/p/1AZrJn2GdW/>
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr: 76, Dt.: 19.12.2024**, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës.”
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 75 Dt.: 19.12.2024**, “Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkoder, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e Znj. Dile Prronaj, banesa e të cilës është dëmtuar nga zjarri.”
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 74 Dt.: 19.12.2024** “Për dhënien në përdorim pa kundërshtim të pasurisë me Nr 3/1034, Zonë kadastrale 8593 Tregu Rus”, në favor të shoqërisë aksionere “Bio Strajca”
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 73 Dt.: 19.12.2024** “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026”
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 72 Dt.: 19.12.2024**, “Për miratimin e nivelit të bursave për nxënësit e viteve të para, viteve të dyta e lart të shkollave të mesme për vitin shkollor 2024-2025.”
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 71 Dt.: 19.12.2024**, “Për përdorimin e fondit shtese mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri ne 6%) për muajin Nëntor 2024.”
- Njoftim per mbledhjen: <https://www.facebook.com/share/p/1Bh2xL41qw/>
- Transmetim live: <https://fb.watch/xP5qzmC1Ab/>
<https://fb.watch/xP5rG25xWe/>
- Facebook link: <https://www.facebook.com/share/p/1GapZ6ohLU/>
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 70 Dt.: 06.11.2024**, “Për miratimin e dhënies me qira/përdorim të sipërfaqes 0.320 ha në Ekonominë Pyjore “Pruemos Sheldi”, ngastra 104, Nj.A.Gur i Zi, fshati Sheldi, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatëse, aerogjeneratorë për...”
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 69 Dt.: 06.11.2024**, “Për saktësim dhe përditësimin e të dhënave të pjesshme të VKK Postribë nr.13 datë 09.06.2005 “Miratimi i inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Postribë” miratuar me VKM-në nr.477...”

- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr: 68 Dt.: 06.11.2024** "Për një ndryshim dhe shtesë në VKB Nr.5 dt:05.01.2022 "Për miratimin e rrjetit të linjave dhe tarifës së biletave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve për periudhën afatmesme 2022-2024..."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 67 Dt.: 06.11.2024** "Për një ndryshim në VKB Nr.8 datë 31.01.2024, Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e Bashkisë Shkodër për "Projektin Hold On- nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit..."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 67 Dt.: 06.11.2024** "Për një ndryshim në VKB Nr.8 datë 31.01.2024, Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e Bashkisë Shkodër për "Projektin Hold On- nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit..."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 66 Dt.: 06.11.2024** "Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr.55, datë 29.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashisë Shkodër" të ndryshuar"
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 65 Dt.: 06.11.2024** "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Tetor 2024"
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 64 Dt.: 06.11.2024** "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shtator 2024"
- Njoftim për mbledhjen: <https://www.facebook.com/share/p/1A76EKSKFJ/>
- Transmetim live: <https://www.facebook.com/share/v/161pjQvxm6/>
- Facebook link: <https://www.facebook.com/share/p/15uR2HuMCC/>
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 63 Dt.: 30.09.2024** "Për strehimin emergjent të familjes Bejtja në njësitë e banimit tek Banesat Sociale me qira pranë qendrës komunitare " Për Familjen" nr.6 (Ish konvikti i shkollës Pyjore)."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 62 Dt.: 30.09.2024,** "Për miratimin e planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane, Bashkia Shkodër 2024"
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 61 Dt.: 30.09.2024,** "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 60 Dt.: 30.09.2024** "Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e znj. Merita Sheqeri, z. Fatbardh Beqiri, znj. Semiha Çelepija,..."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 59 Dt.: 30.09.2024,** "Për miratimin e udhëzuesit të aplikimit për zbatimin e skemës së granteve."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 58 Dt.: 30.09.2024** "Përmiratimin e rishpërndarjes së fondit brenda të njëjtit program për vitin 2024"
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 57 Dt.: 30.09.2024** "Për një shtesë dhe ndryshim në VKB Nr.55 datë 29.12.2023 " Përmiratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar."

- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 56 Dt.: 30.09.2024** "Për një shtesë dhe ndryshim në VKB Nr.55 datë 29.12.2023 " Përmiratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar."
 - **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 55 Dt.: 30.09.2024,** "Për një shtesë dhe ndryshim në VKB Nr.55 datë 29.12.2023 " Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër "
 - **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 54 Dt.: 30.09.2024,** "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civil të punonjësve administrativë të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë."
 - **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 53 Dt.: 30.09.2024,** "Për miratimin e rishpërndarjes së fondit të zërave nga shpenzime korrente tek projektet e investimeve brenda të njëjtit program për vitin 2024."
 - **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 52 Dt.: 30.09.2024,** "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për **muajin Gusht 2024.**"
 - **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 51 Dt.: 30.09.2024,** "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Korrik 2024".
- Njoftim per Mbledhjen: <https://www.facebook.com/share/p/14tXjY38xV/>
 - Transmetim Live: <https://www.facebook.com/share/v/19nCBz42QP/>
<https://fb.watch/xP64DgKj01/>
<https://fb.watch/xP65IVVEs0/>
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 50 Dt.: 31.07.2024,** "Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e znj. Alma Muliu, z. Saim Isufi , znj. Sajda..."
 - **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 49 Dt.: 31.07.2024,** "Për një ndryshim në VKB nr. 55, datë 29.12.2023, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", të ndryshuar;
 - **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 48 Dt.: 31.07.2024,** "Dhënie pëlqimi për pranimin e sponsorizimit nga subjekti 'Raiffeisen Invest', Sh.a në cilësinë e sponsorizuesit për investim dhe zbatim në kuadër të "Rikualifikimit të hyrjeve së disa shkollave të qytetit, Shkodër"...."
 - **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 47 Dt.: 31.07.2024,** "Për strehimin emergjent të zj. Xh. B dhe fëmijëve të mitur në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira pranë qendrës komunitare "Për familjen" nr. 6 (ish-konvikti i shkollës..."
 - **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 46 Dt.: 31.07.2024,** "Për transferimin e fondit të mbetur gjendje në llogari jashtë thesari, për projektin "Nxitja e përfshirjes sociale dhe zhvillimit të komunitetit" nga llogaria e dedikuar e projektit tek të ardhurat..."

- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 45 Dt.: 31.07.2024**, "Për dhënie pëlqimi për pranimin e donacionit nga World Vision Albania, në cilësinë e donatorit për investimin dhe zbatimin e projektit "Kënd lojrash".
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 44 Dt.: 31.07.2024**, "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6 %), për muajin qershor 2024."
- Njoftim i mbledhjes: <https://www.facebook.com/share/p/15yaGRhqAG/>
- Transmetim live: <https://www.facebook.com/share/v/1BNAtde1Q9/>
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 43 Dt.: 28.06.2024**, "Për dhenie mendimi për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, largimin dhe përpunimin e ujrave të ndotura."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 42 Dt.: 28.06.2024**, "Për miratimin në parim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe Bashkisë Shkodër për zbatimin e projektit "Sunny Schools", i cili ka për qëllim instalimin..."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 41 Dt.: 28.06.2024**, "Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr.55, datë ,29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër , i ndryshuar."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 40 Dt.: 28.06.2024**, "Për miratimin e projektit të parë të prograntit buxhetor afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Shkodër."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 39 Dt.: 28.06.2024**, "Për miratimin e listës shtese të përfituesve dhe masën e subvencionimit të interesave të kredive për individë/familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët me kredi të lehtësuara nga shteti..."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 38 Dt.: 28.06.2024**, "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Maj 2024. "
- Njoftimi për mbledhjen: <https://www.facebook.com/share/p/1Uvfg6wJ1Q/>
- Transmetim live: <https://www.facebook.com/share/v/18nBpLC2pz/>
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 37 Dt.: 31.05.2024**, "Për miratimin e vjeljes, mbledhjes, grumbullimit dhe shitjes me procedurë ankandë publik të prodhimeve të dyta pyjore të boçeve të pishës, rrënjëve të shqopës, bimëve mjekësore tanifere dhe eterovajore natyrore..."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 36 Dt.: 31.05.2024**, "Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e Znj.Lize Qehaja dhe Znj. Mirsada Rrila, banesat e të..."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 35 Dt.: 31.05.2024**, "Për një ndryshim në VKB-në nr.7 datë:31.01.2024 "Për miratimin e listës së përfituesve për programin social të strehimit" "Banesa sociale me qira" për instrumentin financiar "Subvencionimi i qirasë në tregun..."

- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 34 Dt.: 31.05.2024**, "Për miratimin e planit vendor të veprimit për energji dhe klimë 2023-2030."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 33 Dt.: 31.05.2024**, "Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit viti 2023, të Bashkisë Shkodër"
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 32 Dt.: 31.05.2024**, "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Prill 2024."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 31 Dt.: 31.05.2024**, "Për emërimin e sekretarit të Këshillit bashkiak, Shkodër."
- Njoftim per mbledhjen: <https://www.facebook.com/share/p/1DyKtrmPjZ/>
- Transmetim live: <https://fb.watch/xP7BL5Vtwx/>
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 30 Dt.: 29.04.2024** "Për lirimimin për shkak të dorëheqjes të sekretarit të Këshillit Bashkiak Shkodër."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 29 Dt.: 29.04.2024**, "Për miratimin e Programit të Transparencës në Bashkinë Shkodër."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 28 Dt.: 29.04.2024**, "Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 27 Dt.: 29.04.2024**, "Për dhënien në përdorim të pasurisë prej 140.42 ha ndodhur në Ekonominë pyjore "Drin Gjadër Kir" parcela 004, 010, zk 1690 nr. Pasurie 888, për një periudhë 10 vjeçare për..."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 26 Dt.: 29.04.2024**, "Për miratimin e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të ekonomisë pyjore "Lugina e Kirit", Njësia administrative Pult, ngastra 189b, me sipërfaqe 250 m², me afat 5-vjeçar, për vendosjen e..."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 25 Dt.: 29.04.2024**, "Për miratimin e planit "Për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor në Bashkinë Shkodër për vitin 2024."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 24 Dt.: 29.04.2024**, "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Shkodër."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 23 Dt.: 29.04.2024**, "Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2023 të Bashkisë Shkodër."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 22 Dt.: 29.04.2024**, "Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të bashkisë së Shkodrës për vitet 2025-2027. "
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 21 Dt.: 29.04.2024**, "Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira në administrimin e Bashkisë Shkodër për vitin 2024."
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 20 Dt.: 29.04.2024**, "Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e bashkisë Shkodër për projektin "Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen."

- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 19 Dt.: 29.04.2024**, "Për një ndryshim në VKB nr.55 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar."
 - **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 18 Dt.: 29.04.2024**, "Për një shtesë në buxhetin e vitit 2024 e miratuar me VKB. Nr.55 datë:29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër..."
 - **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 17 Dt.: 29.04.2024**, "Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr.55 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar. "
 - **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 16 Dt.: 29.04.2024**, "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Mars 2024."
 - **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 15 Dt.: 29.04.2024**, "Për plotësimin e vakancës dhe dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit bashkiak Z. Fatmir Vojvoda."
 - **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 14 Dt.: 29.04.2024**, "Për plotësimin e vakancës dhe dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit bashkiak Znj.Anita Amuli."
-
- Njoftim per Mbledhjen: <https://www.facebook.com/share/p/15kLXWT6W8/>
 - Transmetim live: <https://fb.watch/xP7OegoUu7/>
<https://fb.watch/xP7PnTfZ3q/>
 - **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 13 Dt.: 20.03.2024**, "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri ne 6%) për muajin Shkurt 2024."
 - **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 12 Dt.: 20.03.2024**, "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri ne 6%) për muajin Janar 2024."
-
- Njoftim per Mbledhjen: <https://www.facebook.com/share/p/1BdJXoV2Dw/>
 - Transmetim Live: <https://fb.watch/xP7XTBQt7q/>
 - **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 11 Dt.: 31.01.2024**, "PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET APLIKUESE, TË CILAT NUK JANË SHPALLUR PËRFITUESE NGA SISTEMI I PIKËZIMIT DHE QË DO TË TRAJTOHEN NGA FONDI SHITESË..."
 - **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 10 Dt.: 31.01.2024**, "PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E ZNJ. FATMIRA CANI , Z. MENDUH CANI , Z...."
 - **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 9 Dt.: 31.01.2024**, "PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS SË BASHKËFINANCIMIT DHE LISTËS SË PËRFITUESVE PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "RIKONSTRUKSION RRUGËT FERMENTIM"

- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 8 Dt.: 31.01.2024**, "PËR NJË SHITESË PLANI DHE NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR PËR "PROJEKTIN HOLD ON – NXITJA E AKSESIT NË MBËSHTETJEN E SHËNDETIT MENDOR PËR TË RINJTË"
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 7 Dt.: 31.01.2024**, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE VLERËS SË SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR ATO INDIVIDË/FAMILJE QË NUK PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË PËR VITIN 2024"
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 6 Dt.: 31.01.2024**, "PËR NJË NDRYSHIM TË PJESSHËM TË VKB NR. 51 DATË 14.04.2009 "MIRATIMIN E LISTËS SË PJESSHME TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE QË KËRKOHEN PËR TRANSFERIM NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR",...
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 5 Dt.: 31.01.2024**, PËR DEKLARIMIN E MBARIMIT PARA KOHE TË MANDATIT TË KËSHILLTARIT BASHKIAK ZNJ. HELGA SALLAKU
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 4 Dt.: 31.01.2024**, "PËR DEKLARIMIN E MBARIMIT PARA KOHE TË MANDATIT TË KËSHILLTARIT BASHKIAK Z. GJOVALIN DARRAGJATI"
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 3 Dt.: 31.01.2024**, "MIRATIMIN E HARTËS SË PËRGJITHSHME TË PLAZHEVE TË LEJUARA NË TERRITORIN E LIQENIT TË SHKODRËS, BASHKIA SHKODËR
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 2 Dt.: 31.01.2024**, PËR MIRATIMIN E HARTËS SË PËRGJITHSHME TË PLAZHEVE TË LEJUARA NË TERRITORIN BREGDETAR TË NJËSISË ADMINISTRATIVE VELIPOJË, BASHKIA SHKODËR
- **Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 1 Dt.: 31.01.2024**, PËR PËRDORIMIN E FONDIT SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR PËR NDIHMËN EKONOMIKE (DERI NË 6 %), PËR MUAJIN DHJETOR 2023